
AKT THEMELIMI
“I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar”
“EAGLE LAND VACATIONS” SH.P.K

Sot me date 05.08.2022 une i nenshkruari Dritan Alem Hoxha, lindur ne Borsh dhe banues ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne adresen 8836 Oleander ave Morton Grove ILL 60053 madhor, me zotesi te plote per te vepruar, shtetas Amerikan, mbakjtes Pasaportes me nr 521095662, po regjistroj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “EAGLE LAND VACATIONS”

Neni 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijojte Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrtimin **“EAGLE LAND VACATIONS” SH.P.K me kapital themeltar 2000 \$ (dymije dollar) ose 226 000 leke (dyqind e njezete e gjashtemije)leke.**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Sarande ne lagjen nr.1, Rruga Skenderbeu, godina private 5-kateshe nr.60, kati i pare.

Ortaku i vetem i kesaj Shoqerie do te jete z.DRITAN HOXHA

Shoqeria **“EAGLE LAND VACATIONS” sh.p.k** ka te drejte te krijojte filiale Brenda dhe jashte Shqiperise, ne menyra te drejte dhe me kohezgjatje ashtu si kunder e konsideron te arsyeshme dhe me miratimin e organeve kompetente te vendeve perkatese.

Neni 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik.

Aktivitet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual.

Statuti i shoqerise eshte bashkalidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.



Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si një entitet juridik fillon me miratimin e krijimit të saj nga ana e organeve kompetente të shtetit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohe.

Shoqëria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga të gjithë ortakët e saj.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë:

Aktivitet në fushën e Turizmit, Agjensi e shërbimeve Detare dhe Turistike e cila do të ushtrojë veprimtari në:

1. Ofrimin e shërbimeve të furnizimit me produkte (të ndryshme) dhe klasa të ndryshme karburanti për mjete lundruese detare si jahte (AGO / ULSD dhe LSMGO / MGO), anije etj. Shoqëria do të punojë drejtpërdrejt me klientët duke përfshirë kompanitë e menaxhimit të jahteve, Kapitene & Inxhinierët, tregtarët dhe agjentët e jahteve.
2. Eagle Land Vacations sh.p.k., fillimisht do të ushtrojë aktivitetin në territorin dhe portet detare të Republikës së Shqipërisë si pjesë e strategjisë afatshkurter të saj dhe në kuadrin, e një strategjie afatgjatë synon tërheqjen dhe fitimin e klientëve të mëtejshëm si dhe përfshirjen e zgjerimin e saj në tregje të vecanta duke synuar rritjen e saj në portet e rajonit dhe më gjere.
3. Ofrimin e shërbimeve teknike për mjete lundruese detare, pastrime për jahtet dhe anije të tjera si dhe shërbime të tjera të nevojshme për këto të fundit (riparime, menaxhimi & mirëmbajtja, ruajtja dhe dimerimi, zëvendësimi antifouling dhe sakrifikues i anodes, shërbimet e tekstilit me fije qelqi dhe shërbime karpenterie të anijeve etj.)
4. Ofrimin e shërbimeve dhe furnizimit të bordit.
5. Rezervime për jahtet, organizime udhëtimesh, qiradhenie të mjeteve, planifikime itinerimesh, asistencë dhe shërbime mbi formalitetet doganore dhe ato të emigracionit.
6. Udhëtime Turistike dhe guida turistike në të gjithë territorin e Shqipërisë por edhe jashtë saj.
7. Shërbime dhe aktivitete që përfshijnë zhytje, diving, eksplorime nenujore (sipas legjislativës në fuqi duke përfshirë edhe autorizimin, marrjen e licensave perkatese si dhe kryerjen e kualifikimeve të nevojshme).
8. Cdo veprimtari tjetër, e cila lidhet në mënyrë të drejtperdrejtose tërthorazi me këtto veprimtari, dhe që mund të mos jetë përmendur me sipër në këto objekt, por, as nuk është ndaluar si në këtë akt themelimi ashtu edhe nga legjislativën në fuqi, të cilat shihen se janë të dobishme dhe të nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e shoqërisë.



Gjithashtu Shoqeria mund te ushtroje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 2000\$ (dymije dollare) I konvertuar ne leke me kursin e dites 226 000 leke (dyqind e njezete e gjashte mije) leke i ndare ne nje kuote te vetme me vlere nominale 226 000 leke per kuote e cila zoterohet nga ortakut i vetem i shoqerise z.Dritan Hoxha

Kapitali themeltar eshte depozituar nga aksioneri apo ortakut i vetem ne emer te shoqerise.

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet,pervec ketij akti themelimi,me normat e vendosura ne statut,kundrejt nenshkrimit te ortakeve dhe aprovimit nga Qendra kombetare e Biznesit,diten qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet midis ortakeve ne perpjestim me aksionet e tyre ne shoqeri.

Cdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vete te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 7

Per borxhet qe munde te ekzistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria ,do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar,anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 8

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

Neni 9

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.


Neni 10

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesja sjhoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.



Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakt dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues


DRITAN HOXHA

DRITAN HOXHA

STATUTI
“I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar”
“EAGLE LAND VACATIONS” SH.P.K

Parashikimet e ketij statusi zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut :

- ❖ “Ligji “ eshte Ligji Nr.9901,date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” I azhornuar
- ❖ “Statuti” eshte Statuti i Shoqerise
- ❖ QKB-Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi

KREU I

Themelimi,Emri,Objekti,Kohezgjatja,Selia

Neni 1

Data e Themelimit,Emri dhe Themeluesit

1.1.Me date 05.08.2022 une i nenshkruari Dritan Alem Hoxha lindur ne Borsh,Bashkia Himare dhe banues ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes me adrese 8836 Oleander ave Morton Grove ILL 60053 , madhor me zotesi te plote per te vepruar, shtetas Amerikan,,mbajtes i pashaportes Amerikane me Nr.5210955662 po regjistroj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “EAGLE LAND VACATIONS” e cila do te jete 100% e huaj dhe do te ushtroje aktivitetin e saj brenda dhe jashte Shqiperise dhe do te ndereveproj e bashkepuoj me Kompanite e tjera qe une z.Dritan Hoxha zoteroj ne ermrin time ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes.

Neni 2

Objekti

2.1.Aktivitet ne fushen e Turizmit ,Agjensi e sherbimeve Detare dhe Turistike e cila do te ushtroje veprimtari ne:



1. Ofrimin e shërbimeve të furnizimit me produkte (të ndryshme) dhe klasa të ndryshme karburanti për mjete lundruese detare si jahte (AGO / ULSD dhe LSMGO / MGO), anije etj. Shoqëria do të punojë drejtpërdrejt me klientët duke përfshirë kompanitë e menaxhimit të jahteve, Kapitene & Inxhinieret, tregtarët dhe agjentët e jahteve.
2. Eagle Land Vacations sh.p.k., fillimisht do të ushtrojë aktivitetin në territorin dhe portet detare të Republikës së Shqipërisë si pjesë e strategjisë afatshkurter të saj dhe në kuadrin, e një strategjie afatgjate synon tërheqjen dhe fitimin e klientëve të mëtejshëm si dhe përfshirjen e zgjerimin e saj në tregje të vecanta duke synuar rritjen e saj në portet e rajonit dhe më gjërë.
3. Ofrimin e shërbimeve teknike për mjete lundruese detare, pastrime për jahtet dhe anije të tjera si dhe shërbime të tjera të nevojshme për këto të fundit (riparime, menaxhimi & mirëmbajtja, ruajtja dhe dimerimi, zëvendësimi antifouling dhe sakrifikues i anodes, shërbimet e tekstilit me fije qelqi dhe shërbime karpenterie të anijeve etj.)
4. Ofrimin e shërbimeve dhe furnizimit të bordit.
5. Rezervime për jahtet, organizime udhëtimesh, qiradhenie të mjeteve, planifikime itinerarësh, asistencë dhe shërbime mbi formalitetet doganore dhe ato të emigracionit.
6. Udhëtime Turistike dhe guida turistike në të gjithë territorin e Shqipërisë por edhe jashtë saj.
7. Shërbime dhe aktivitete që përfshijnë zhytje, diving, eksplorime nenujore (sipas legjislacionit në fuqi duke përfshirë edhe autorizimin, marrjen e licensave përkatëse si dhe kryerjen e kualifikimeve të nevojshme).
8. Cdo veprimtari tjetër, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë tërthorazi me këtto veprimtari, dhe që mund të mos jetë përmendur më sipër në këtë objekt, por, as nuk është ndaluar si në këtë akt themelimi ashtu edhe nga legjislacionet në fuqi, të cilat shihen se janë të dobishme dhe të nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e shoqërisë.

2.2. Gjithashtu Shoqëria mund të ushtrojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër dhe që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 3

Kohezgjatja

3.1 Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak. Ajo mund të ndryshojë emrin, seline, objektin e veprimtarisë dhe kohezgjatjen e saj si dhe çdo gjë tjetër me vendim të ortakut të vetëm.



Neni 4

Selia

4.1. Selia e shoqerise ndodhet ne Sarande ne adresen Lagja nr.1, Rruga Skenderbeu, godina private 5-kateshe, Nr.60, kati i pare ,Sarande.

4.2 Adresa e kontaktit elektronik te shoqerise eshte dritanhoxha@comcast.net dhe nr.telefoni 069 43 34 003.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 2000 \$ (dymije dollar) ose ne leke e konvertuar me kursin e dites 113 leke/\$ 226 000 leke. i ndare ne nje kuote te vetme me vlere nominale 2000 \$ per kuote e cila zoterohet nga ortakut i vetem i shoqerise z.Dritan Hoxha

5.2 Kontributi i ortakëve te tjere nese do te kete , mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri e luajtshme/e pa luajtshme ose te drejta)

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit ose ortakut te vetem te shoqerise.

6.2 Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

6.3 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4 Ne te gjitha raset zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



Neni 7

Transferimi I Kapitalit

7.1. . Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi vendimarrës

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës I shoqerise

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimarrës I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. . Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

8.4. Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë të përgjithshme, në bazë të autorizimit nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.5. Administratori i shoqërisë nuk mund të vepronte si përfaqësues i ortakëve në asambletë të përgjithshme.

8.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asambletë të përgjithshme e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asambletë të Përgjithshme

9.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asambletë.

9.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 10

Kuorumi

10.1.Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2.Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3.Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1.Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse dhe vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;gj)
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.3.Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes.

12.1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
ç) dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

12.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

13.1.Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

13.2.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.



13.3. Z.Dritan Hoxha do te jete ortaku i vetem i shoqerise dhe njekohesisht edhe administrator i saj me nje afat 5-vjecar deri ne emerimin e te tjereve (nese do te lind nevoja) nga asambleja e shoqerise .

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1.Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2.Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshmene rastet kur:

-Sipas Bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme Brenda tre muajve ne vazhdim.

-Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktivet,te cilat kane nje vlere me t elarte se 5% te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3.Nese Asambleja e Pergjitheshme emeron me shume se nje administrator,ata e administrojne bashkerisht shoqerine

14.4.Asambleja e Pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te mardhenieve kontraktore me shoqerine,regullohen sipas dispozitave ligjiore ne fuqi.



Neni 15

Pergjegjessite e Administratorit

15.1.Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.2.Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3.Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dënimshpërbiejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

15.4.Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dënimshpërbiejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;



- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

KREU IV

Viti financiar-Ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16.1.Viti financiar I Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit QKB. dhe mbyllet me 31 Dhjetor ose mund te perfshihet ne pasqyart financiare te vitit te dyte te plote financiar.

Neni 17

Ekspertet

17.1.Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve

17.2.Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuarpregatit raportin me shkrim per nxjerrjen e r ezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi vazen e te drejtes vjetore qe ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1.Prishja e shoqërise mund t ebehet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim gjykatë;dh) për arsye të tjera të parashikuara në statut.

18.2.Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise ,duke caktuar nje apo disa likuidator dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”

18.3 Prishja e shoqerive tregtare jka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise pagauese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4.Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

18.5.nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve,Brenda 30 diteve pas prishjes cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise,bashkimi-ndarja.

19.1. Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve. Ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne epjesen IX te Ligjit 9901dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

Neni 20

Baza Ligjore

20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar

20.2.Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter spsecifik ne Republikën e Shqiperise.

Ortaku i vetem i Shoqerise

DRITAN HOXHA

